



*Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenin 14 dhe 15 të Ligjit për pronën publike Nr.08/L-125. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, me kërkesën e Drejtorisë së për Arsim të datës: 28.02.2024 me nr. prot-01Nr.463-6103/2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2024 të mbajtur me 29.03.2024, mori këtë:*

## V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit për ndërrimin e titullarit pronës, parcela me Nr. P-71006024-00422-2 ZK Klinë e cila evidentohet me emër: pronë shoqerore Shkolla Fillore "V.Karaxhiq" e njëjta regjistrohet në emer të Komunës së Klinës.
2. Ndërrimi i tutullarit të pronës si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qellim të fillimit të procedurave për ndërtimin e çerdhës së re.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

### Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria e Arsimit;
- Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-11315 /24  
Klinë me 03.09 /24



Kryesuesi,  
Fadil Gashi